



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 08, datë 17.05.2019

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “SHITESË E IMPIANTIT TË PËRPUNIMIT TË UJIT NË BOVILLË, HERRAJ, BASHKIA KAMËZ DHE BASHKIA TIRANË”


Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të “Ujësjellës Kanalizime Tiranë” sh.a., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Shtesë e impiantit të përpunimit të ujit në Bovillë, Herraj, Bashkia Kamëz dhe Bashkia Tiranë”, me zhvillues “Ujësjellës Kanalizimet Tiranë” sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit ligjor;
 - b) miratimit të akteve përkatëse sipas legjislacionit të posaçëm për trashëgiminë kulturore;
 - c) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Kamëz dhe Bashkia Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

